



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 08.01.2013
Nr. 0204--1359

Xhavit Dakaj
Sekretarin e Përgjithshëm
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

Lënda: Shkresë Përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 28.12.2012 ka pranuar **Vendimin për ndarjen e bursave të studentëve të Komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2012/2013**, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, ju si ministri Kryesuese e Komisionit, po ju përcjellim për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë këtë Vendim.

Bashkangjitur gjeni Vendimin e lartshënuar të Komunës së Kaçanikut

Me respekt,


Besnik Osmani,

Sekretar i Përgjithshëm
Ministrisë së Administrimit të Pushtetit
Lokal

Kopje: Alush Istogu,-MASHT
Liridona Ajeti,-MPMS
Isuf Zeneli,-MAPL
Arkivit të MAPL-së

DALEŠE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr.
Br. 0204-1359/1
No.

Data
Datum 08.01.2013
Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Pristina, Dana: 08.01.2013
Br.0204--1359

Xhavit Dakaj
Generalni Sekretar
Ministarstvo obrazovanja nauke i Tehnologije

Predmet: Propratni dopis

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave je dana 28.12.2012 primilo **Odluku za dodelu stipendija studentima Opštine Kačanik za akademsku godinu 2012/2013**, usvojene od Skupštine Opštine Kačanik, u cilju procenjivanja zakonitosti.

Na osnovu Odluke Vlade br. 2/119 od dana 07.04.2010 o formiranju komisija za razmatranje lokalnih akata, vi kao ministarstvo predsedavajuće Komisije, dostavljamo vam na razmatranje i procenjivanje zakonitosti ove Odluke.

U prologu ćete naći gore navedenu Odluku Opštine Kačanik .

S poštovanjem,

Besnik Osmani,

Generalni Sekretar

Ministarstvo administracije lokalne
samouprave

Kopija: Alush Istogu,-MONT
Liridona Ajeti,-MRSZ
Isuf Zeneli,-MALS
Arhivi MALS



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
- Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16-31150/12
Kaçanik, 24.12.2012

| | | | |
|---|--------------|---------|-------|
| HYRESE-ULAZNA-INCO REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO DEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO | | | |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration | | | |
| Data Datum Date 28.12.2012 | | | |
| Ngjyra organizativne | Nr. i Lëndës | Shënime | Vlera |
| - 111 - | 2204-1319 9 | | |

Në bazë të nenit 12, 17 dhe 40.2 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 17 Ligjit nr. 03/L-048- Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 2 të Ligjit nr. 03/L-049 –Për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 24.12.2012 mori:

V E N D I M
PËR NDARJEN E BURSIVE TË STUDENTËVE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN AKADEMIK 2012/2013

I.

Me këtë Vendim lejohet ndarja e bursave për studentët e komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2012/2013 në shumë 20.000.- €, (njëzetmijë euro), duke u siguruar mjetet nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve prej programit buxhetor të Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorisë së Arsimit, në përputhje me Buxhetin e miratuar të komunës për vitin fiskal 2013.

II.

Për realizimin e pikës I të këtij Vendimi, Kuvendi i komunës do të formoj komisionin për hartimin e draft - Rregullores për ndarjen e bursave.

III.

Draft - Rregullorja si në pikën 2 të këtij vendimi, do të miratohet në kuvend, në të cilën do të përcaktohen të gjitha aktivitetet dhe procedurat deri në përmbylljen e plotë të këtij procesi, si: numri i studentëve të rregullt të cilët do të përfitojnë këtë mbështetje financiare nga buxheti i komunës, lartësinë e shumës mujore dhe kriteret e tjera relevante për studim të mundshëm të cilët mund të marrin bursë nga komuna gjatë vijimit të studimeve të rregullta në vitin akademik 2012/2013.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës, dhe do të zbatohet në intervalin kohor prej dhjetë(10) muaj, për sa zgjatë viti akademik 2012/2013.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, ndërsa ekzekutimin financiar do ta bëjë Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim njoftohen:

Kryetari i Komunës,
Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës,
Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe
Arkiva

Kryesuesi i Kuvendit,
Z. Xhelaf Gashi